



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:101307

Datë: 05.12.2024

Numri i dokumentit: 06550923

P.nr.28/22

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, nga gjyqtari i vetëm Sabaheta Kurteshi me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Gjelbrim Gërdellaj, **në lëndën penale ndaj të pandehurit H. (Q.) M. nga fshati..., Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të Kodit Penal të Kosovës, nr. 06/L-074, sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.793-8/22 të dt. 19.05.2022, duke vendosur lidhur me Marrëveshjen për Ndërmjetësim me shifrën ND>.nr.181/24 të dt. 12.08.2024 e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prizren, në mes të të pandehurit H. M. dhe të dëmtuarës KEDS – Distrikti në Prizren, konform nenit 357 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së dhe nenit 14 të Ligjit për ndërmjetësimin Nr.06/L-009, jashtë seance me dt. 04.12.2024 merr këtë:**

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësimin, e lidhur ndërmjet të pandehurit H. M. nga fshati..., Komuna e Dragashit dhe të dëmtuarës KEDS – Prizren, marrëveshje e lidhur në Qendrën e ndërmjetësimit në Prizren, me numer te rastit Ndr.181/24 të dt. 12.08.2024.

II. HUDHET POSHTË Aktakuza e Prokuroris Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm me PP/II.nr.793-8/22 të dt. 19.05.2022.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit **H. M. nga fshati..., Komuna e Dragashit**, i lindur më..., me nr. Personal..., i biri i Q., dhe nënës H., i martuar, i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës.

- Për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KP-së.

IV. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.793-8/22 të dt. 19.05.2022, ka paraqitur Aktakuzën kundër të pandehurit H. M. nga fshati..., Komuna e Dragashit, me nr. personal..., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 i KP-së.

Gjykata me dt. 29.04.2024, ka caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilin shqyrtim ka prezentuar Prokurori i shtetit Elfete Purova nga Prizreni dhe i pandehuri H. M.

Në këtë shqyrtim fillestar pikërisht i pandehuri i ka propozuar gjykatës që kjo çështje penale të dërgohet në procedurë të ndërmjetësimit dhe pas dhënies së mendimit nga ana e prokurorit të shtetit që këtë çështje ta dërgoj në marrëveshje në procedurë të ndërmjetësimit, gjykata ka marr aktvendim ku ka aprovuar propozimin e të pandehurit dhe këtë çështje penale juridike konform ligjit për ndërmjetësimin dhe dispozitat ligjore të KPPK-së, me dt. 03.05.2024, gjykata propozimin bashkë me shkresat e lëndës i ka dërguar në Qendrën e Ndërmjetësimitm përmes kordinatorit të Gjykatës.

Gjykata me dt 26.08.2024 ka pranuar shkresat e lëndës ku bashkangjitur ka qenë edhe marrëveshja për zgjedhjen e ndërmjetësuar që mban shenjë Ndr.nr.181/24 të dt. 12.08.2024, marrëveshje e përpiluar dhe e nënshkruar prej palëve prezente, tek Qendra e ndërmjetësimit në Prizren. Gjykata pas shiqimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësimin, ka konstatuar se palët në procedurë, pa ndonjë kërcënim, me vullnetin e tyre e kanë arritur marrëveshjen si në vijim: Pala B, i pandehuri ka deklaruar se i vjen keq për rastin që ka ndodhur, dhe që i ka shkaktuar dëm material palës “A” dhe se pajtohet me këtë marrëveshje të ndërmjetësimit për pagesën e dëmit material si në marrëveshje, shumën totale prej 1527.37 euro, të cilën shumë do ta paguaj me 10 (dhjetë) këste mujore, ku pagesa e këstit të parë është bërë me dt. 12.08.2024, ndërsa pagesat e kësteve tjera dhe atë në shumë prej 152.74 duhet të bëhet për muajt vijues dhe atë prej datës 1-5 të muajve pasues deri në pagimin total të borxhit. Pala “A” hjekë dorë nga djekja penale ndaj palës “B”, dhe duke u bazuar në faktin se pala “B” do ta përmbushë obligimin sipas marrëveshjes. Me këtë rast palët e konsiderojnë rastin e mbyllur me këtë marrëveshje të arritur në procedurë të ndërmjetësimit. Deklaron se pajtohet me këtë marrëveshje të ndërmjetësimit e gjithashtu deklarun se pajtohet që pagesa e borxhit dhe atë në shumë prej 1527.37 të bëhet me 10 këste sipas muajve vijues të cekur në dispozitiv të kësaj marrëveshje.

Gjykata vlerësoi se marrëveshja për ndërmjetësim pasqyron vullnetin e lirë të palëve dhe është e lidhur në pajtim me ligjin andaj duke vepruar në pajtim me nenin 15 par.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësim nr. 06/L-009, me datë 16.2021 e aprovoi këtë marrëveshje e cila pas aprovimit nga Gjykata, kjo marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor konform nenit 455 par. 1 të KPPRK-së.

Nga se u tha më lartë konform nenit 357 par. 1 pika 1.3 të KPPRK-së lidhur me neni 15.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH –
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2022:101307, 04.12.2024

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankese.